

Pershendetje!

Une jam D... K..., gazetare. Por ne kete moment jam edhe ne poziten e konsumatores, pasi rasti eshte personal.

Ne lidhje me blerjet online me vlere mbi 22\$, me nje vendim tuajin eshte vendosur tvsh edhe per blerjet per perdonim personal dhe jo per tregti.

Pyetja e pare:

Pse kjo tvsh eshte aplikuar mbi vleren e produktit + vleren e transportit, nderkohe qe tvsh e transportit eshte e perfshire ne pagesen e transportit qe eshte bere qe ne momentin qe eshte kryer pagesa per produktet online?

A nuk ju duket qe po aplikoni tvsh mbi tvsh-ne? Si mund ta justifikoni nje tvsh te dyte, mbi nje sherbim (si transporti), qe eshte paguar me gjithe tvsh? Sepse cmimet jepen gjithnjeh me tvsh.

Ajo qe mua si konsumatore me takon te paguaj, eshte vetem tvsh-ja mbi artikujt, pasi shitesi i huaj nuk e ka paguar kete per shtetin shqiptar, ashtu sic e ka paguar per shtetet e BE-se mbi nje marreveshje.

Pyetja e dyte:

Ku bazohet taksa doganore 2% per suplementet?

Agjencia Doganore - nje strukture nen varesine tuaj, merr nje takse doganore per suplementet qe ne rastin e pakos sime eshte 2% (270 leke). Vertet shume eshte e vogel, dicka si nje buzeqeshje, por nuk eshte ceshtje e vleres sesa e se vertetes. Ne Nomenklaturen e Kombinuar te Mallrave 2022 (dogana.gov.al/dokument/3841/nomenklatura-2022), del se suplementet e perfshire ne Produktet Farmaceutike jane pa takse. Konkretisht, Kapitulli 29 Kimikatet Organike, KODI NK 2936 , XI. Vitaminat, provitaminat dhe hormonet". Ne kolonen e ketij kodi dhe te gjitha produktet e tjera jane shenuar 'pa takse'. Gjithashtu edhe kapitulli 30 Produktet Farmaceutike, tek lista Kodi NK 3004 50 00 thote: "Te tjera, qe permbajne vitamina apo produkte te tjera te kreut 2936, pa takse".

A keni nje shpjegim per kete?

Pyetja e trete:

Doganat tuaja vjelin permes DHL-se, nje tarife te dyte te quajtur SHERBIMI DOGANOR (Deklarate e Thjeshtezuar), qe sipas DHL-se, eshte tarife fikse 1800 leke per blerjet me vlere mbi 10 mijë leke, qe vilet per llogari te doganave. A mund te me thoni, se ku e bazoni ju vjeljen e kesaj tarife doganore me vlere 1800 leke? A ka ndonje ligj, VKM ose qofte edhe UDHEZIM te Ministrise suaj?

Pas verifikimeve qe kam bere, me ka rezultuar se kjo nuk ka nje baze ligjore. Nuk e kam gjetur as ne faqen zyrtare te Ministrise se Financave, as ne faqen zyrtare te Doganave, as ne Fletoren Zyrtare, as ne mediat e shumta qe kane pasqyruar ndryshimet ne legjislacion per blerjet online dhe dergesat personale. Dhe dicka qe u fshihet mediane, si rasti i tarifave, tingellen e paligjshme. Megjithate, nese ju me ofroni bazen ligjore te kesaj pagese, une do ta paguaj ate me kenaqesi te madhe.

Ministria e Financave, Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, me nr. protokolli 879/1, me 15.1.2018 kane leshuar nje Udhezim "Mbi zbatimin e procedurave per deklarimin dhe clirim ne qarkullim te lire te mallarave personale me natyre jo-tregtare te hyra si dergesa postare ose blerje on-line nga indicidet nepermjet operatoreve postare". Ky udhezim tregon se kur duhet te kryhet deklarata e thjeshtuar dhe kur nuk duhet. Dhe sipas ketij udhezimi, per blerjet online me vlere mbi 22 euro

duhet te paraqitet deklarate e thjeshtuar. Por nuk ka asnje moment ne udhezim, qe te tregoje se vilet ndonje tarife per plotesimin e deklarares se thjeshtuar.

Pyetja e katert:

Ku perfundon kjo tarife per Formularin e Deklarates se Thjeshtuar- tek DHL apo tek Doganat (shteti)? A eshte kjo, nje vjedhje nga ana e DHL-se qe behet fshehurazi dhe per te cilen shteti yne nuk ka dijeni, apo shteti ka dijeni per kete dhe e ka lejuar sepse persona te caktuar ndajne pjesen?

Nuk ka asnje qytetar te BE-se qe te paguaj kaq shume per te njejtat produkte te blera on-line dhe une kete e kam vertetuar permes nje investigimi personal. Qytetaret e BE-se kur blejne jashte BE-se, i paguajne shitesit (ne kete rast amerikan-iHerb), vleren e produktit plus tvsh-ne dhe nuk paguajne tvsh tjeter ne vendin e tyre. Pasi ne baze te nje marreveshjeje te korrikut 2021, tvsh-ne ua paguan shitesi, vendeve te BE-se. Dakord deri ketu: Sepse qytetari i Greqise, Italise apo Frances etj e ble produktin online me gjithe tvsh, ndersa qytetari shqiptar duhet te paguaj tvsh-ne ne doganen e vendit te tij. Por ndersa qytetari i BE-se per blerje me vlera mbi 40 apo 60 euro (sipas vendit), paguan zero transport dhe gjithashtu nuk paguan asnje lloj takse tjeter doganore, aq me pak nje takse te dyfishte doganore, qytetari shqiptar paguan edhe transport, edhe taksa te dyfishta doganore. Perse duhet te paguaj populli shqiptar me teper se popujt e BE-se me standard me te larte ekonomik?

Konkretisht po bez nje prove.

Kam futur ne shporten e iherb disa produkte me vlore 61.37 dollare. Transporti me DHL eshte 31.10 dollare dhe shuma totale eshte 92.47 \$. Tani, kur te mberrije nje pako e tille ne doganen shqiptare, ju do t'i ngarkoni 22% tvsh, plus takse doganore, plus edhe 1800 leke qe shkojne se bashku rreth 2000 leke, ose rreth 19 dollare. Dhe si perfundim, konsumatori shqiptar paguan $92.47\$ + 19\$ = 111.47 \$$.

Tani le te shikojme se sa paguan qytetari italian per te njejtat produkte. Ai paguan 67.51\$. Zero transport. Dhe ne vendin e tij nuk paguan asgje tjeter, sepse jane te paguara per qeverine e tij nga dyqani iHerb, pra nga shitesi me marreveshjen e korrikut 2021....

Tani le te shohim se sa paguan per te njeften pako qytetari grek. Ai paguan 69.35\$. Dhe zgjedh nje poste qe ben dergesa falas, sic zgjedh gjithnjje vellai im. Dhe asnje pagese tjeter shtese.

Tani le te shohim se sa paguan ne perfundim qytetari francez per te njeften pako. Ai paguan 57.36\$

Pra qytetari shqiptar paguan gati dyfishin e qytetarit italian, qytetarit grek dhe atij francez, per blerje online jashte territorit te BE-se.

Pra, per blerjet qe vellai im ka realizuar tek iHerb ne vleren rreth 117 euro, doganat tuaja kerkojne 4824 leke, nga te cilat, 1800 leke nje tarife doganore e paligjshme, 270 leke nje takse doganore qe per suplementet ushqyese eshte zero dhe nje TVSH te dyfishte, ku 600 leke jane te teperta pasi aplikohen mbi sherbimin e transportit te paguar njehere tek ju. Ne total, 2760 leke me teper sesa duhet paguar.

Kerkojme qe te anuloni tarifen prej 1800 lekesh, nese nuk mund t'i gjeni asaj bazen ligjore dhe te na e ofroni, qe do te na bindte se po paguajme dicka qe eshte detyrim i drejte.